



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Nr. 104 / prot.
1

Tiranë, më 13.2.2023

URDHËR

Nr. 124, datë 13.2.2023

PËR

**MARRJEN E MASAVE DHE MONITORIMIN E VEPRIMTARISË, SJELLJES
APO PËRDORIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE
LOGJISTIKE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË PROCESIT
ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET LOKALE, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të Nenit 14. shkronja a. të Ligjit nr. 53/2022, datë 29/07/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të Kodit Zgjedhor të RSH dhe të vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik në çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

U R D H Ë R O J:

1. Vënien në dispozicion dhe njohjen nga ana e të gjithë stafit të Vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik në çdo institucioni publik, me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
2. Raportimi në ndërfaqen e KQZ të realizohet nga Znj. Daniela Zeneli me detyrë Asistente e Drejtorit Ekzekutiv, jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose të aktivitetit publik.
3. Drejtoria e Administratës si dhe Drejtorët e Drejtorive janë përgjegjës për:

- a. monitorimin dhe raportimin për punonjësit që kanë në varësi. Raportimi në rast të konstatimit të shkeljes së urdhërit do të kryhet tek Sektori i Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Administratës.
- b. monitorimin në mënyrë të vazhdueshme të veprimtarisë së punonjësve të Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC), me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të institucioneve/ administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje;
- c. publikimin e të dhënave të kontaktit në faqen zyrtare të internetit të AAC-së, duke kërkuar denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes, apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të AAC-së në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje;
- d. verifikimin dhe analizimin e të dhënave që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës, përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale;
- e. verifikimin që automjetet dhe karburanti, të ndalohen të përdoren për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje;
- f. njoftimin e stafit për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore;
- g. marrjen e masave dhe realizimin e monitorimit të zbatimit të parashikimeve ligjore për të garantuar:
 - i. mospërdorimin e burimeve njerëzore të AAC-së në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore dhe subjekteve zgjedhore, zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 - ii. mospërdorimin e fondeve të AAC-së për veprimtarinë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;
 - iii. mospërdorimin e mjeteve dhe materialave në inventar të AAC-së, për veprimtarinë e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;
 - iv. moslejimin e veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;
 - v. moslejimin në fushatë zgjedhore të pjesëmarrjes së administratës së AAC-së brenda orarit zyrtar.

4. Gjatë orarit zyrtar punonjësit nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari apo organizim politik, të tilla si mitingje apo të ndonjë natyre tjetër, për llogari të forcave të ndryshme politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.

5. Punonjësi nuk duhet të bëhet pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të institucionit, me kolegët apo qytetarët, të mos përdorë apo mbajë postera, fletëpjosje dhe objekte me simbole të subjekteve politike në ambientet e institucionit, të mos lejojë përdorimin apo mbajtjen e posterave, fletëpalosje dhe të simboleve të subjekteve politike, nga qytetarët që marrin shërbime në ambientet e institucionit.

6. Pas orarit zyrtar, punonjësi nuk duhet të shprehet publikisht për bindjet apo preferencat politike, gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme politike, nga forca të ndryshme politike.

7. Mosrespektimi i dispozitave të këtij urdhri nga punonjësit e Autoritetit , përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore.

8. Me këtë Urdhër të njihen të gjithë punonjësit e AAC-së.

9. Ngarkohet gjithë stafi i AAC-së për zbatimin e këtij Urdhri deri në datën 13 Maj 2023.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

